

## Politika e Menaxhimit të Cilësisë

Cilësia është e rëndësishme për aktivitetin tonë, pasi ne i vlerësojmë klientët tanë. Ne përpiqemi në mënyrë të vazhdueshme t'u sigurojmë klientëve tanë shërbime që janë në konformitet me kërkesat e tyre, madje dhe të tejkalojnë pritshmëritë e tyre.

Me besimin se cilësia, shërbimi për klientët dhe teknologjia e avancuar do të cojnë në përmirësim të vazhdueshëm në të gjitha zonat operacionale të Portit.

Synojme certifikimin me ISO 9001, duke ndërmarrë programe të menaxhimit të cilësisë që inkurajojnë bashkëpunim, komunikim, vendimarrje racionale, përmirësojnë eficientë operacionale, identifikojnë dhe menaxhojnë riskun.

Ne angazhohemi për përmirësim të vazhdueshëm dhe kemi krijuar një Sistem Menaxhimi të Cilësisë i cili siguron një platformë për matjen dhe përmirësimin e performancës sonë.

Ne kemi hartuar dhe implementojmë procedurat e mëposhtme për të na mbështetur në synimin tonë për të kënaqur klientët gjatë zhvillimit të aktivitetit dhe ofrimit të shërbimeve:

- Marrja e mendimit të klientëve dhe monitorimi i kërkesave të tyre.
- Procedurat e ankimit të klientëve.
- Zgjedhja e furnitorëve/kontraktorëve në bazë të praktikave dhe teknologjive më të mira si dhe monitorimi i performancës së tyre.
- Trajnimi i punonjësve të Kompanisë sonë.
- Auditimi i vazhdueshëm i zhvillimit të procedurave brenda Kompanisë.
- Vendosja e objektivave të matshme që reflektojnë qëllimin e biznesit të Kompanisë sonë
- Rishikimi i rezultateve të auditimit të Kompanisë

Megjithëse Drejtori i Përgjithshëm ka përgjegjësinë e drejtpërdrejtë për Menaxhimin e Cilësisë në aktivitetin e Kompanisë, të gjithë punonjësit kanë përgjegjësi në fushat e aktivitetit të tyre, duke bërë të mundur që performanca me Cilësi të jetë e integruar në të gjithë komponentët e zhvillimit të veprimtarisë.

Kjo Politikë publikohet në faqen zyrtare të Kompanisë sonë.

Aleksandër LIPIVANI

Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv

Datë: 25.04.2017